# BULETINI INFORMATIV

## DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**MARS 2025**

## MARRËVESHJE ME PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas e përfaqësuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogace dhe znj. Suela Qevani, Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Ofruesve të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, lidhi marrëveshje me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan mbi vënien në dispozicion pa kundërshpërblim të ambienteve për funksionimin e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridik Parësore Elbasan.

## 13 TRAJNIME TË ZHVILLUARA NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME FAKULTETET E DREJTËSISË







Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, referuar Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të lidhura me 13 fakultete të drejtësisë, ka zhvilluar trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas për 293 studentë. Gjatë trajnimit studentët u informuan mbi ndihmën juridike parësore, dytësore dhe rolin e Klinikave të Ligjit në ofrimin e shërbimit të Ndihmës Juridike Falas. Studentët pjesëmarrës u mikpritën për t'u angazhuar në praktikën 3 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. Në përfundim të praktikës, studentët e angazhuar, do të pajisen me certifikatë të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë.







## FINALIZIMI PËR HERË TË DYTË I PROCEDURËS SË FINANCIMIT TË ORGANIZATAVE JO-FITIMPRURËSE TË FINANCUARA NGA MINISTRI I DREJTËSISË

U finalizua për herë të dytë procedura e financimit të Organizatave Jo- fitimprurëse, të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Pas zhvillimit të procedurës së konkurimit 4 organizata përfituan financim nga buxheti i shtetit për vitin 2025.

QENDRA PSIKO-SOCIALE VATRA

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116 117

QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

# PËRFUNDON PROCESI I LIDHJES SË KONTRATAVE TË SHËRBIMIT ME 140 AVOKATË, PJESË E LISTËS SË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

**Përfundoi procesi i lidhjes së kontratave të shërbimit me 140 avokatë, pjesë e listës së ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore. Sigurohet përfaqësimi me avokatë falas nga të gjitha dhomat vendore të avokatisë në Shqipëri.**






Në datën 16.03.2025 u publikua kronika e dytë e intervistës së punonjëses të **QSHNJP Gjirokastër** lidhur me kategoritë e veçanta përfituese të Ndihmës Juridike Falas.

**QSHNJP Gjirokastër** në datën 10.03.2025 zhvilloi një intervistë me median lokale RTSH Gjirokastër mbi ndërmjetësimin.

**QSHNJP Gjirokastër** dhe **QSHNJP Përmet** në datën 20.03.2025, në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit zhvilluan një aktivitet informues me pjesëmarrjen e kategorive të veçanta përfituese të Ndihmës Juridike Falas.



**QSHNJP Gjirokastër** dhe **Përmet** në datën 20.03.2025 zhivilluan një aktivitet ndërgjegjësues Street Law mbi ligjin nr.111/2017 *"Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti"*.

**QSHNJP Përmet** në datë 21.03.2025, ora 10:30, organizoi një takim informues në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe Ditës Ndërkombëtare të Diskriminimit Racial.





**QSHNJP Përmet** zhvilloi në datën 28.03.2025 një intervistë me RTSH Gjirokastra, me fokus ofrimin e ndihmës juridike parësore për qytetarët në nevojë.

**QSHNJP Vlorë** në datën 04.03.2025, në kuadër të trajnimeve të mbajtura nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, zhvilloi trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas me studentë të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë ku i prezantoi studentët me ligjin nr.111/2017 *"Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti"*.





**QSHNJP Vlorë** ishte e ftuar në një takim në kuadër të projektit "Mbështetje nëpërmjet punësimit dhe arsimimit për anëtarët e minoritetit Rom dhe Egjiptian në Bashkine Vlorë".

**QSHNJP Vlorë** në datën 17.03.2025 ishte pjesë e një takimi të organizuar nga anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Dhunës në Familje,





**QSHNJP Vlorë** në datën 21.03.2025 me ftesë të Shoqatës Internacionale për Solidaritetin, mori pjesë në takimin në kuadër të projektit "Promovimi i edukimit gjithëpërfshirës përmes edukimit të kombinuar për nxënësit e komunitetit Rom dhe Egjiptianë në Bashkinë Vlorë"

**QSHNJP Vlorë** ishte e ftuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në një takim pranë Njësisë Administrative Orikum ku u diskutua mbi bashkëpunimin mes institucioneve.



**QSHNJP Lushnje** në datën 12.02.2025 mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë.

**QSHNJP Kavajë** në datën 13.03.2025 zhvilloi trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas me studentët e Universitetit "Aleksandër Moisiu".

**QSHNJP Durrës** zhvilloi në datën 21.03.2025 zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues pranë ambienteve të Qendrës Komunitare Multifunksionale Nishtulla, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Eleminimit të Diskriminimit Racial .



**QSHNJP Durrës** organizoi në datën 27.03.2025 aktivitet informues, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për të Vërtetën, pranë Shkollës "Qemal Mici".



**QSHNJP Korçë** në datë 21.03.2025 zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Down dhe Ditës Ndërkombëtare të Eleminimit të Diskriminimit Racial, pranë Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit.



**QSHNJP Korçë** në datë 25.03.2025 zhvilloi një takim me nxënës të Gjimnazit "Themistokli Gërmenji" ku informoi nxënësit mbi ligjin nr. 111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"*.





**QSHNJP Fier** në datën 17.03.2025 mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe ANAD mbi kategoritë e veçanta si përfitues të shërbimeve ligjore.



**QSHNJP Fier** në datën 21.03.2025 organizoi një aktivitet informues pranë Qendrës "Epoka e Re", me fokus informimin mbi ligjin nr.111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"*.



**QSHNJP Fier** në datën 20.03.2025 mori pjesë në takimin e organizuar në kuadër të projektit "Shëndet për të Gjithë" ku u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit mes institucioneve për një shërbim sa më dinjitoz për kategoritë e veçanta.



**Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas** dhe **QSHNJP Tiranë** zhvilluan trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.



**Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas** dhe **QSHNJP Tiranë** zhvilluan në datën 11.03.2025 trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas me studentë të Universitetit Europian të Tiranës.

**QSHNJP Shkodër**, në vazhdimësi të trajnimeve të iniciuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, zhvilloi trajnimin mbi Ndihmën Juridike Falas, pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi".